



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 20, datë 24.12.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË ME FUNKSION  
HOTEL “NOVA HOTEL FIVE STAR”, ZYRA, SHËRBIME DHE BANIM 35 KATE  
MBI TOKË DHE 6 KATE NËNTOKË, ME VENDNDODHJE  
NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Ferro Beton & Construction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: Godinë me funksion hotel “Nova Hotel Five Star”, zyra, shërbime dhe banim, 35 kate mbi tokë dhe 6 kate nëntokë, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Ferro Beton & Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Vendimi Nr. 47, datë 28.12.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: “Godine me funksion hotel “Nova Hotel Five Star”, zyra dhe shërbime 5-13, 5-14, 13 dhe 14 kate mbi tokë, me 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë,





me subjekt zhvillues shoqërinë “Ferro Beton & Construction CO” sh.p.k si dhe Dokumenti i Lejes së Ndërtimit Nr. 121/15 Prot., datë 18.06.2021, shfuqizohen.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 13/03 / 2025